

VENDIM
Nr. 657, datë 10.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 793, DATË 24.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 10142, DATË 15.5.2009, ‘PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË POLICISË SË BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, të vendimit nr. 793, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

a) Në pikën 1, të shkronjës “B”, paragrafi “Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive nëse ka përfutuar ose jo tokë, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, vetëm nga personat që janë banorë në fshatra”, shfuqizohet.

b) Në shkronjën “F”, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët, me këtë përmbajtje: “... me përjashtim të personave, të cilët kanë përfutuar tokë sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore dhe ushtrojnë aktivitetet si persona të vetëpunësuar në bujqësi.”.

2. Efekti financiar vjetor nga zbatimi i këtij vendimi llogaritet në shumën 18 milionë lekë. Për vitin 2019, efekti financiar llogaritet në shumën 10 milionë lekë dhe përballohet nga fondet e parashikuara në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të këtij viti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe